

# RELACIONI TEKNIK I PROJEKTIT TE PROPOZUAR

**"Ndertim-funksionimi i rrjetit te levizshem  
te komunikimeve publike (GSM), per  
sherbimin publik telefonik te levizshem  
tokesor nepermjet frekuencave E-GSM  
900 GSM 1800 MHz dhe UMTS 2100 MHz"**

**Stacioni 1516 – Cekreze, Tirane**

Shoqeria Investitore: "ALBANIAN MOBILE COMMUNICATIONS" sh.a.

Hartoi raportin:



Qellimi i ketij aktiviteti eshte ndertim-funksionimi i rrjetit te levizshem te komunikimeve publike (GSM), per sherbimin publik telefonik te levizshem tokesor nepermjet frekuencave E-GSM 900 GSM 1800 MHz dhe UMTS 2100 MHz", duke ndertuar nje platform per montimin e nje antene tip "Greenfield" ne Stacionin 1516 – Cekreze, Tirane.

Eshte nje aktivitet qe ka ndikim jo shume te madh ne mjedis, vetem ne fazen ndertimore te tij. Bazuar ne Ligjin Nr. 10440, date 07.07.2011, "Per Vleresimin e Ndikimit ne Mjedis", Shtoja II, klasifikohet si aktivitet qe i nenshtrohet Procedures Paraprake te Ndikimit ne Mjedis dhe paiset me Vendim per VNM Paraprake. Specifikisht klasifikohet ne: Pika 10. *Prodhime infrastrukturore / a) Projekte për zhvillimin e pasurive të patundshme industriale;* Shoqeria Investitore: "ALBANIAN MOBILE COMUNICATIONS" sh.a. (AMC), me NIPT J61814094W, ka lidhur kontrate me shoqerine "Energia B" me NIPT K31714095E, per te projektuar dhe realizuar ngritjen e antenes celulare ne kete stacion. Kontrata eshte lidhur mes dy paleve ne 1 Prill, 2014.

Gjithashtu Shoqeria AMC, ka lidhur kontrate me 18.11.2013, me Z. Muhamet Kopaci, zoterues i nje siperfaqe prej 48 000 m<sup>2</sup>, prej nga e cila 300 m<sup>2</sup>, merret me qera nga shoqeria per te ndertuar platformen ku do te mbeshtetet antena.  
(Bashkangjitur aplikimit, kontratat e siperpermendura)

### **Vendodhja e aktivitetit**

Aktiviteti ne vleresim ndodhet ne Fshatin Cekreze, Komuna Zall-Herr, Rrethi Tirane. Trualli eshte toke arre, i dhene me qera per kete lloj aktiviteti. Infrastruktura rrugore eshte ekzistuese dhe nuk eshte e nevojshme hapja e nje rruge te re.

**Tipi i antenes: Greenfield (antene qe montohet ne terren te hapur)**

**Lartesia e antenes: 30 m**

**Siperfaqja e truallit: 300 m<sup>2</sup>**

**Zona Kadastrale: Nr. 1377**

**Numri i pasurise: 300**

**Indeksi i hartes: K-34-88 (202-0)**

**Koordinatat: X = 41° 24' 18.8'' dhe Y = 19° 48' 21.8''**

